

VENDIM
Nr. 183, datë 10.11.2017

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE SHA, PËR NJË NDRYSHIM NË
“KONTRATËN E SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI/KESH SHA DHE
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SHA, PËR FURNIZIMIN E
KLIENTËVE FUNDORË, PËR PERIUDHËN 1.1.2017–31.12.2017”, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S
NR. 62, DATË 11.5.2017**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike; si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, të funksionimit dhe të procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për ndryshimin e pikës 1, të nenit 9, të “Kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.5.2017,

konstatoi se:

Në mbështetje të VKM-së 244/2016, me vendimin nr. 62, datë 11.5.2017, ERE ka miratuar “Kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 21380, datë 20.9.2017, ka përcjellë në ERE kërkesën për ndryshimin e pikës 1, të nenit 9 të “Kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, ndërmjet shoqërisë së prodhimit, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.5.2017.

- MIE me shkresën nr. 5643/9 prot., datë 28.9.2017, shprehet se kërkesa e OSHEE sh.a. për ndryshimin e kontratës aktuale ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a., nuk gjen mbështetje në parashikimet e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- KESH sh.a., me shkresën nr. 4858/1 prot., datë 27.9.2017, shprehet se propozimi i OSHEE sh.a. është i pabazuar dhe në kundërshtim me VKM-në datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, por edhe nuk përputhet me detyrimet që burojnë nga licenca e KESH-it dhe ajo e OSHEE-së.

- Në nenin 5, pika 3, të VKM-së nr. 244/2016, parashikim i cili është reflektuar në nenin 9, pika 1 të kontratës, përcaktohet se: Në rastet kur shoqëria publike e prodhimit nuk mund të sigurojë sasinë e kërkuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, sipas parashikimeve të vendosura në pikën 3 të këtij neni, ky i fundit ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar. FSHU-ja kompensohet

nga shoqëria e prodhimit të energjisë, për sasinë e siguruar në tregun e parregulluar, sipas diferencës ndërmjet çmimit të rregulluar dhe prodhimit të energjisë elektrike dhe çmimit mesatar të bursës hungareze HUPEX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë elektrike produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse”. Në këto kushte, kërkesa e OSHEE sh.a. për ndryshimin e kontratës aktuale ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a nuk gjen mbështetje në parashikimet e VKM-së së sipërcituar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. mbi ndryshimin e pikës 1, neni 9 të “Kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, nga shoqëria e prodhimit, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën 1.1.2017–31.12.2017”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 62, datë 11.5.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti